

UDHËZIM
Nr.52, datë 28.12.2009

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE AFATEVE PËR SHTYPJEN DHE SHPËRNDARJEN E DOKUMENTACIONIT TATIMOR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 135 pika 2 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, si dhe pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1149, datë 25.11.2009 “Për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit tatimor” Ministri i Financave

UDHËZON:

1. “Shtypshkronja e letrave me vlerë“, sh.a. me kapital tërësisht shtetëror në varësi të Ministrisë së Financave do të mundësojë shtypjen e dokumentacionit tatimor sipas porosisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe kushteve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1149, datë 25.11.2009 “Për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit tatimor”.

2.Shtypshkronja pranon porosi vetëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe dorëzon dokumentacionin e kërkuar vetëm te porositësi.

Shtypshkronja e letrave me vlerë” sh.a.nuk pranon asnjë porosi që nuk vjen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Të drejtën e shpërndarjes së dokumentacionit tatimor e ka vetëm administrata tatimore qendrore.

3.Procedura për fillimin e shtypjes së dokumentacionit tatimor fillon me nënshkrimin e kontratës midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe “Shtypshkronjës së letrave me vlerë” sh.a., e cila duhet të garantojë prodhimin e dokumentacionit sipas specifikimeve teknike, formateve, modeleve, kushteve. Sasia, cilësia dhe garancia e mallit të kërkuar do të përcaktohen në kontratën e lidhur midis dy palëve.

4.Formati, informacioni apo standardet e sigurisë të çdo dokumenti tatimor që do të prodhohet do të jenë të miratuara nga Ministri i Financave apo Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Në momentin që Ministria e Financave apo Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve vendosin të ndryshojnë një nga dokumentet tatimore, të miratojnë një dokument të ri ose të heqin nga qarkullimi një dokument tatimor, brenda 5 ditëve pas marrjes së vendimit duhet të njoftohet edhe shtypshkronja e letrave me vlerë sh.a.

5. “Shtypshkronja e letrave me vlerë“ sh.a. para lidhjes së kontratës, përgatit analizën e kostos për çdo dokument tatimor që do të prodhohet.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ngre një komision të posaçëm, i cili shqyrton dhe vendos lidhur me koston e paraqitur nga shtypshkronja e letrave me vlerë sh.a., si dhe harton specifikimet teknike për çdo dokument tatimor.

6.Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode